

VENDIM
Nr. 232, datë 18.8.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E
SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE” SHPK PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 40, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1566/5 prot., datë 14.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘NOA Energy Trade’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 243, datë 2.12.2021, me afat vlefshmërie deri më 2.12.2026.

- Shoqëria ka paraqitur pranë ERE-s kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1564/1 prot., datë 26.5.2026 brenda afatit të përcaktuar në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Gjatë shqyrtimit të aplikimit u konstatua se shoqëria kishte ndryshuar ortakun që kontrollon interesat e saj pa autorizimin paraprak të ERE-s. Në vijim të verifikimeve dhe korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, u vlerësua situata, lidhur me ndryshimin e ortakut kontrollues dhe përmbushjen e kërkesave përkatëse ligjore e rregullatore. Për sa më sipër, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 229, datë 10.8.2026, u vendos autorizimi i ndryshimit të ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k.”

- Në këto kushte, vlerësohet të vijohet me shqyrtimin e aplikimit për rinovimin e licencës.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga shoqëria dhe në referencë të përcaktimeve të rregullores, vlerësohet se shoqëria duhet të sqarojë dhe/ose të depozitojë edhe sa vijon:

- vendimin e organeve drejtuese të shoqërisë, nëpërmjet të cilit të dedikohet vlera përkatëse për financimin e të paktën 1 (një) muaji të ushtrimit të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike;

- informacion/saktësime, në lidhje me afatin e kontratës së qirasë për disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit;

- informacion, në lidhje me afatin e kontratës për disponimin e sistemit IT dhe realizimin e procesit të faturimit;

- informacion, në lidhje me mënyrën e realizimit të matjes për klientët e saj;

- informacion, në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të furnizimit të energjisë elektrike gjatë 5 viteve të fundit të licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën administrative për rinovimin e licencës nr. 494, seria F21, dhënë shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 243, datë 2.12.2021, me afat vlefshmërie deri më 2.12.2026.

2. Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k. të plotësojë dhe të depozitojë pranë ERE-s dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar, në përputhje me kërkesat e nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës të njoftojë shoqërinë “NOA Energy Trade” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti